

VENDIM
Nr. 252, datë 24.4.2024

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 137, DATË 6.3.2024, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURËS
PËR DHËNIEN E PRONËS SHTETËRORE ME QIRA, ENFITEOZË, *LEASING*,
SHITJE, PËRDORIM SI KOLATERAL DHE TË PËRDORIMIT NË FORMA TË
TJERA NGA ANA E KORPORATËS SË INVESTIMEVE SHQIPTARE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 71/2019, “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 3, të kreut II, të vendimit nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, shkronja “ë” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ë) në përfundim të zhvillimit të projektit, pas lidhjes së kontratave përkatëse të kalimit të pronësisë mbi objektin/objektet e ri/të reja, autorizimin e AIC-së për të kërkuar regjistrimin e sipërfaqeve shtetërore në pronësi të Republikës së Shqipërisë dhe në përgjegjësi administrimi ose në përdorim të partnerit publik, apo në pronësi të njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore ose të entit publik përkatës, në përputhje me kontratën. Pavarësisht nëse prona në gjendjen fillestare i është transferuar AIC-së në përdorim apo në pronësi, në çdo rast, në përfundim të zhvillimit të veprës, pjesa që i përket partnerit publik regjistrohet drejtpërdrejt në pronësi të Republikës së Shqipërisë dhe në përgjegjësi administrimi ose në përdorim të partnerit publik, apo në pronësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore, ose të entit publik përkatës, sipas rastit.”.

2. Ngarkohen e Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Korporata e Investimeve Shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama